

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Isa Kelmendi, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit PTP “T.” me seli në .., përfaqësuar nga D. A.-S., nga, Komuna e ..., të cilën e përfaqëson i autorizuari S. Z., av. nga ..., kundër të paditurit I. H., nga, Komuna e ..., të cilin me autorizim e përfaqëson S. Z., objekti i kontestit – dorëzimi i posedimit të paluajtshmërisë, duke vendosur sipas revizionit të paditurit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2766/13 datë 28.3.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2766/13 datë 28.3.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2766/13 datë 28.3.2018, është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.422/07 datë 24.4.2013, me të cilën në pjesën e I-rë të dispozitivit është aprovuar kërkesëpadia e paditësit PTP “T.” me seli në Gjilan dhe është obliguar i padituri I. H. nga Komuna e ..., që paditësit t’ia lirojë lokalin afarist në Qendrën Tregtare “B.” në ..., përdhese, lokali nr. 8 në sipërfaqe prej 7,05 m², nga njerëzit dhe sendet, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Në pjesën e dytë të dispozitivit të aktgjykimit në fjalë është obliguar i padituri që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumë prej 684 € në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, revizion ka paraqitur i padituri, duke goditur të njëjtin për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 188 të LPK-së dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe tejkalimit të kërkesëpadisë me propozim që të dy aktgjykimet të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Pas vlerësimit të aktgjykimit të goditur dhe shkresave të lëndës , në kuptim të nenit 215 të LPK-së, Gjykata Supreme ka gjetur se:

Revizioni i paditurit është i pabazuar.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar se paditësi “T.” me seli në Gjilan më datë 28.9.1998, kishte lidhur kontratë mbi bashkimin e mjeteve për ndërtimin e lokalit afarist në Qendrën Tregtare “B.” lam. ..., përdhese, lokali nr. 8, me sipërfaqe prej 8 m2 dhe atë me Drejtorinë për tokë ndërtimore në Gjilan. Paditësi në bazë të kontratës mbi bashkimin e mjeteve ka përmbushur të gjitha detyrimet ndaj Drejtorisë për tokë ndërtimore në Gjilan duke paguar shumën prej 35.000,00 dinarë, në llogari të Ndërmarrjes “Binaçka Morava” me seli në Gjilan, i cili ka qenë kryesi i punëve, ndërsa me datë 25.11.1998 kishte bërë pagesën edhe të shumës prej 30.000,00 dinarëve në llogari të Drejtorisë për ndërmarrje publike në Gjilan. I padituri pretendon se të drejtën e pronësisë në lokalin afarist ka fituar në bazë të kontratës me shkrim të pavërtetuar në mes të paditësit dhe A. J., të cilin lokal ka blerë nga Ndërmarrja publike në Gjilan.

Gjykata e shkallës së parë, në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike dhe provave të vërtetuara, ka vërtetuar se paditësi, si pronar i lokalit afarist, ka të drejtë të kërkojë dorëzimin e lokalit afarist si pronar jo posedues kundër poseduesit jo pronar në bazë të nenit 37 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridiko-pronësore (Fletorja zyrtare e RSFJ-së nr. 6/1980).

Gjykata e shkallës së dytë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, ka pranuar në tërësi konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se paditësi është pronar i lokalit afarist në bazë të bashkimit të mjeteve dhe se vërtetimi i paraqitur nga i padituri I. H. se A. J. prej të cilit paditësi pretendon se ka blerë lokalin afarist, kishte paguar çmimin blerës të lokalit afarist V. A., pasi që me ekspertizë grafologjike është konstatuar se nënshkrimi në vërtetim nuk është i V. A..

Në bazë të kësaj gjendjeje Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën e të paditurit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së dytë pasi që paditësi ka provuar se të drejtën e pronësisë në lokalin

afarist ka fituar në bazë të kontratës mbi bashkimin e mjeteve që është një prej mënyrave të fitimit të pronësisë në bazë të nenit 20 të LTHMPJ.

Gjykata Supreme, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës më të ulët sipas të cilit është aprovuar kërkesëpadia e paditësit, pasi që me provat e administruara paditësi ka provuar se të drejtën e pronësisë ka fituar në bazë të bashkimit të mjeteve me Drejtorinë për tokë ndërtimore në Gjilan dhe se në bazë të kësaj kontrate paditësi në tërësi ka përmbushur detyrimet nga kjo kontratë duke paguar çmimin e blerjes Ndërmarrjes “Binaçka Morava” dhe Ndërmarrjes publike. Prandaj, në bazë të kësaj paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të veprimit juridik që është një prej mënyrave të fitimit të së drejtës së pronësisë në bazë të nenit 20 të LTHMPJ. E drejta e pronësisë është e drejtë e garantuar në bazë të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku në par. 3 është *‘përcaktuar se askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga prona.’* Neni 1 i Protokolit 1 i Konventës Evropiane për Drejtat dhe Liritë themelore garanton të drejtën e pronësisë si drejtë elementare të njeriut dhe askush nuk mund të ndërhyjë në shfrytëzimin e qetë të drejtës së pronësisë.

Paditësi në bazë të nenit 37 LTHMPJ ka të drejtë të kërkojë dorëzimin e sendit individualisht të përcaktuar nga personi që ka posedimin e sendit dhe se i padituri ka të drejtë të përdorë kundërshtimet duke provuar të drejtën e pronësisë që në rastin konkret nuk ka mundur të provojë pasi që paditësi ka bazën juridike të fitimit të drejtës së pronësisë në lokalin afarist i cili është objekt i kontestit. Prandaj, nuk qëndrojnë thëniet e revizionit të paditurit se i njëjti ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të kontratës së shitblerjes nga A. J., pasi që në procedurë pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar se shitësi A. J. nuk ka pasur të drejtën e pronësisë në lokalin afarist kompensues.

Thëniet e revizionit se çështja më parë është dashtë të shqyrtohet si çështje paraprake pranë Drejtorisë për Kadastër dhe pronë në Gjilan dhe se gjykata është dashtë të shpallet inkompetente në pikëpamje absolute nuk qëndrojnë, ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me një kontest pronësor ku pronari i sendit individualisht të përcaktuar kërkon dorëzimin e sendit nga poseduesi jo pronar, që kjo çështje duhet të zgjidhet me kontest civil. Sa i përket pretendimeve të revizionit se në rastin konkret nuk është respektuar reciprociteti për të paraqitur si palë një subjekt nga

Republika e Serbisë nuk qëndron, ngase paditësi me seli është në Gjilan dhe se kompetente janë gjykatat e Republikës së Kosovës ku gjendet paluajtshmëria.

Gjykata Supreme nuk ka vlerësuar pretendimet e tjera në revizion nga arsyeja se të njëjtit kanë të bëjnë me gjendjen e vërtetuar faktike për çka revizioni nuk mund të paraqitet në kuptim të nenit 214.2 të LPK-së.

Nga arsyet e sipërpërmendura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 222 të LPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.255/2018 datë 10.10.2018

Kryetari i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri